



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2024:032050

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05756912

**P.nr.22/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me sekr. juridike Vjollca Bytyqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarës L.M., nga lagjja Shirokë komuna e Suharekës për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 322 para.2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2344-2/23 të datës 29.01.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 13.05.2024 në prani të prokurorit të shtetit Shahadin Destani, të akuzuarës L.M., mori, publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.05.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E akuzuara,**

**L.M.**, nga i ati ..... e nëna .....e gjinisë ....., e lindur më .....në Kukës Republika e Shqipërisë, tani me vendbanim në lagjen Shirokë komuna Suharekë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shtetas i Republikës së Shqipërisë.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse më datë 28.11.2023, rreth orës 20:10 min., në fshatin Dubravë, komuna e Suharekës, ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit apo asgjësimit të banesës së banuar, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve familjare, me të dëmtuarin Gj.G., e pandehura me një shkrepës i vë flakën tepihut të dhomës së ndejës-sallonit, ku flaka përhapet duke përfshirë edhe mobilet në të njëjtën dhomë, me ç' rast të dëmtuarit i shkakton dëm material.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale zjarrvënja nga neni 322 par. 2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 7, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49 dhe 69 të KPRK-së, si dhe nenit 242, 364 dhe 452 të KPPRK-së, i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Duke ia caktuar dënimin e me burgim prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej dy (2) viteve e akuzuara nuk kryen veprë tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I konfiskohet, një shkrepës ngjyrë e kaltër, si mjet i kryerjes së veprës penale, sipas nenit 277 par. 1 të KPPRK-së

Obligohet e akuzuara që në emër të taksës për kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari, Gj.G., nga fsh. Dubravë komuna Suharekë” për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.2344-2/23 të datës 29.01.2024, e ka akuzuar L.M., nga lagjja Shirokë komuna e Suharekës për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 322 para.2 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 29.05.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i shtetit Shahadin Destani dhe e akuzuara L.M., dhe mbrojtësi sipas detyrës zyrtare av. M.J., .

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, e akuzuara L.M., është deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet. Pas bindjes së gjykatës se e njëjta e ka kuptuar atë plotësisht nga gjykata i është ofruar mundësia e pranimit ose mos pranimit të fajësisë duke iu treguar benifitet e pranimit të fajësisë, e njëjta deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën i vihet në barrë, është penduar për veprën e kryer dhe zotohet se vepra të tilla ose të ngjashme në të ardhmen nuk do të përsëritën.

Prokurori i Shtetit lidhur me deklarin e të akuzuarës për pranimin e fajësisë, ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, pasi që pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë konform dispozitave ligjore të KPPRK-së.

Gjyqtari vetëm gjykues pas deklarimeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarës dhe mbrojtësit të tij rreth pranimit të fajësisë ka marrë aktvendim me anë të cilit ka pranuar deklarin e të akuzuarës për pranimin e fajësisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë sipas nenit 242 të Kodit Procedurës Penale të së Kosovës (KPPK) 08/L-032. Pastaj gjyqtari ka vlerësuar se e akuzuara kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në deklarin e të akuzuarës për ta pranuar fajësinë në tërësi, gjykata nuk administroi me provat në këtë çështje penale juridike, pasi që në mënyrë të pa kontestuar vërtetoi këtë gjendje faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale për të cilën i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat e akuzuara ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës është bërë në pajtim me neni 242 të KPPK-së dhe nga faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale zjarrvënja nga neni 322 para.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 06/L-074.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethana rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarës, bashkëpunimin e përgjithshëm e të akuzuarës me gjykatën, pendimin e sinqertë të të akuzuarës e cila në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë dhe ka premtuar se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, vlerësimi i gjykatës është se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloj të akuzuarën nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)06/L-074.

Gjykata lidhur me kërkesën pasurore-juridike ka vendosur në bazë të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 08/L-032.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 452 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilin është e obliguar e akuzuara që të bëjë kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 449 par. 2 pika 2.9 të KPPRK-së.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal**  
**P.nr. 22/2024, datë 30.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Qemail Suka**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët e pa kënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej **30** ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykatë.